

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“AZGJESIM TE MBETJEVE SPITALORE PER QENDREN SHENDETESORE  
KAMEZ”**

**REF- 85987-11-01-2023**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**90524400-0 Mledhja Transporti dhe Azgjesimi I Mbetje Spitalore**

VLERA E FONDIT LIMIT:

**Fondi Limit: Marreveshje Kuader eshte 2,380,000 (dy milion e treqind e tetedhete mije)  
leke pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

### **1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

1. Të jetë i regjistruar në QKR
2. Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë së tij objektin që prokurohet

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

---

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Xhiroja mesatare vjetore gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020-2021-2022), duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit.

(Shënim: *ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor*)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese*).

2.2.1 Xhiroja mesatare vjetore gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020-2021-2022), duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit.

Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave që ka operatori ekonomik që është regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara me vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

- Bilancet e dy viteve të fundit (2021-2022) të shoqërisë të firmosura nga autoritetet përkatëse.

**Argumentimi Ligjor :** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43 pika 2/c dhe pika 3 VKM 285 dt 19.05.2021 te ndryshuar

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

**Argumentimi i AK:** Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", I ndryshuar, VKM-sënr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm në përmjet forms elektronike".

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2023 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. *(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik i klasifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, para shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave

Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Shërbime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë dy viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këto kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të leshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Operatori ekonomik të këto në ekstraktin e Q.K.R. të cilesuar objektin.
- **License për aktivitetin grumbullim, trajtim dhe azgjësim i mbetjeve spitalore aktive dhe Impianti për Azgjësimin e Mbetjeve duhet të jete në leje Mjedimore, Teknologjia që përdoret për azgjësim të mbetjeve duhet të jete në leje mjedisore të subjektit .**
- Operatori ekonomik të këto kontrate aktive me një Lang Fill për depozitim të produkteve të dale nga përpunimi i mbetjeve spitalore.
- Operatori ekonomik të sjelle vërtetim nga OSHEE që nuk ka detyrime, vërtetim nga Bashkia që nuk ka detyrime të taksave vendore, po ashtu edhe vërtetim që nuk ka detyrime ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Operatori ekonomik duhet të këto lejet mjedisore të tipit A,B.
- Operatori ekonomik duhet të paraqitet sa herë të këto nevojë QSH Kamez për tërheqjen e mbetjeve nga momenti i njoftimit nga AK
- Operatori duhet të paraqesë vërtetim për shlyrjen e OSHEE-se
- **Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë AK certifikatat En-Iso 9001-2015 dhe En-Iso 14001-2015.**

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Mbetje Spitalore	kg	7000

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër deri në Azgjësimin e plote të sasisë së Mbetjeve Spitalore prej 7000 kg**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4, b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.4 Përsa i përket aftësisë teknike dhe profesionale,** Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të vendosura nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

a. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësive, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar).

b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton ISO 14001-2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Certifikatat e mesiperme duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë). Çertifikata të jetë e vlefshme dhe të kete lidhje me objektin e prokurimit. Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik certifikatat duhet të paraqiten të pakten nga secili prej anëtarëve.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e*

*mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*